

Nr. 17212/3 Prot.

Lezhë, më 30/11 /2022

PROCESVERBAL

I mbajtur me datë 22.11.2022 në orën 17:00 në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Gjergj Laca” Lezhë, me prezencën e panelit prej 4 anëtarësh:

1. Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Pjerin Ndreu,
2. Zv.Kryetares së Bashkisë Lezhë- Znj.Eueda Molla,
3. Kryetarit të Këshillit Bashkiak Lezhë -Z.Ndue Luli,
4. Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore-Z.Dritan Boçi,

si dhe në prezencën e banorëve të njësive administrative Shëngjin, Lezhë, përfaqësues nga shoqëria civile, bizneset etj.

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë i cili vendosi theksin në temën e takimit duke pritur sygjërime, propozime në lidhje me buxhetin dhe taksat për vitin 2023.

Paraprakisht, ai bëri një parantezë për ecurinë e bashkisë përgjatë këtyre tre viteve të fundit duke vendosur theksin në ekzistencën e borxhit 4.6 miliard lekësh në momentin e marrjes së detyrës, struktura e mbingarkuar e punonjësve, reduktimi i të cilës i ka kursyer Bashkisë buxhet që më pas është përkthyer në shërbime publike për të gjithë komunitetin. Për shkak të situatave të vështira të kaluara si termeti, pandemia dhe kriza ekonomike, synimi ka qenë ruajtja e ekuilibrit financiar nëpërmjet menaxhimit më të mirë të të ardhurave, pagesat e qirave, reduktimi dhe shkurtimi i shpenzimeve të pa nevojshme, rritja e shërbimeve në qytet. Problematikë ngelet politika e vjeljes së të ardhurave, ndërgjegjësimi për pagesën e taksave por së shpejti do të funksionojë sistemi elektronik ku qytetarët/ bizneset do procedojnë në kohë reale me faturat. Taksa e infrastrukturës nuk mblidhet për shkak të bllokimit të lejeve të ndërtimit.

Aktualisht janë në proces zbatimi projekte të cilat janë fituar nga aplikimet në thirrje të financuara nga fondet e qeverisë, projekte me donacion por edhe projekte të tjera që do fillojnë të zbatohen tani dhe në vitin 2023, në rakordim edhe me qeverinë. Gjithashtu nëpërmjet asistencës nga ekspertë të Bashkimit Evropian do të fuqizohen kapacitetet për aplikime të sukseshme në

projekte. Buxheti i vitit 2023 do të ketë një rritje prej 20%. Deri tani janë bërë ndërhyrje në 22 rrugë rurale dhe 60% e buxhetit të bashkisë ka shkuar për rrugët rurale. Investime të rëndësishme janë bërë për projektin e zonës “Lalm i Ri”, investime në bregun e Drinit, rikualifikimi i lagjeve. Do t’i jepet zgjidhje problemit të ujërave të zeza që derdhen në Drin nëpërmjet daljes tyre në një impiant, eliminimi i përmytjeve për shkak të bllokimit të kanaleve nga ujërat e shirave duke vënë në punë stacione pompimi.

Disa nga projektet kryesore janë:

- Ujësjiellësi i Lagjes “Nënë Tereza”,
- Ujësjiellësi Gocaj-Kakarriq (puna për të cilin do të fillojë në 3-mujorin e parë të vitit 2023),
- Ujësjiellësi i ri i Shëngjinit.

Pas këtyre punimeve do të ndërhyhet në sistemin rrugor.

Disa investime të rëndësishme që janë bërë ose janë në proces janë:

- Trotuari i lagjes “Gjenio”,
- Rikualifikimi i rrugës Ishull-Shëngjin,
- Lagjia e re Ishull-Shëngjin,
- Byepasi i Shëngjinit,
- Rehabilitimi i lulishtes bregut të Drinit, pranë Memorialit,
- Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Gjergj Kastrioti” Lezhë,
- Rikonstrukcion i Pallatit të Kulturës, Bibliotekës,
- Ura në lagjen “Skëndërbeg”, ndërtimi i së cilës do të ndikonte në eliminimin e trafikut veçanërisht në mëngjes,
- Ndërtimi i pallatit në hyrje të qytetit me fondet e veta.

Gjithashtu janë bërë ndërhyrje në zonat periferike që kanë impakt si ndërhyrje në Gjadër, Gocaj, Tale 1, Lagjia e Hotelit etj. Është ofruar përkrahje për grupet sociale vulnerabël, është mundësuar trajtimi i familjeve me bonus social. Për shkak se ka ndryshuar formati i aktiviteteve është rritur numri i aktiviteteve artistike kulturore duke nxitur më tepër pjesëmarrjen si dhe mbështetjen ndaj të rinjve të talentuar. Pallati i Kulturës do të jetë në funksion të artistëve të cilët mund ta shfrytëzojnë ambientet për zhvillimin e kurseve apo aktivitete të ndryshme.

Investimi i rëndësishëm do të bëhet në zonën përballë varrimit të Skënderbeut me rikualifikimin e gjithë asaj lulishteje duke e tjetërsuar në zonë atraktive. Projekti për ndërtimin e pedonale nga Milleniumi deri tek xhamia, spostimi i stadiumit, ndërtimi i dy kate parking dhe një parku kreativ do të zgjidhte problemit e parkimit në Lezhë, ku të gjithë do të parkojnë në parkingun e ri kundrejt një pagese.

Projekti i shëtitorës së Shëngjinit është një projekt që do ta transformojë zonën nga Corali tek porti, duke rritur cilësinë e turizmit. Në bashkëpunim me biznesin do të vijojë pastrimi i gjithë zonës së Shëngjinit. Një ndër projektet në bashkëpunim me Bashkimin European është “Smart City” i cili synon instalimin e paneleve diellore në të gjithë rrjetin e shkollave, kopshteve dhe institucioneve për shkak edhe të mungesës së energjisë elektrike. Në vitin 2023 do të mundësohet financimi i transportit publik, do të përcaktohen stacionet dhe linjat sipas standarteve. Gjithashtu do të vazhdojë të ketë fokus të rëndësishëm bujqësia, kanalet kulluese, vaditëse, zhvillimi i takimeve informuese si dhe përvetësimi nga fondet IPARD nëpërmjet aplikimeve në projekte nga bizneset dhe fermerët. Në vijim të asaj që u parashtrua më sipër, fjala u kaloi të pranishmve për diskutime.

Nisur nga dimensionimi i gjërë që ofron bujqësia një nga qytetarët ishte i interesuar në lidhje me pikat kresore se ku mund të investohet duke marrë shkak edhe nga mbështetja me fonde të huaja të BE-së. Një problematikë tjetër që u evidentua ishte problem i rrugëve të qytetit, të cilat pas ndërhyrjeve të fundit janë ngushtuar më shumë duke vështirësuar kalimin veçanërisht te mjeteve të emergjencës apo zjarrfikëses. Në përgjigje të ankesës, kryetari evidentoi problemin e parkingut në anë të rrugës, problem i cili do të ndiqet dhe do t'i jepet zgjidhje. Ndërkohë theksoi rëndësinë e projektit tek stadiumi i cili do ti jepte zgjidhje përfundimtare këtij problemi.

Një nga përfaqësuesit e Qendrës HANA veçoi si fusha kryesore, si shumë të rëndësishme për përfshirjen në Bashkimin Evropian përkatësisht rininë dhe mjedisin dhe njohjen me planet që ka bashkia për adresimin e tyre. Në lidhje me fushën e mjedisit, u theksua projekti për menaxhimin e mbetjeve si një ndër praktikatat e mira të zbatuara nga Bashkia Lezhë si dhe projektet për rikualifikimin e lulishteve nëpërmjet asistencës nga arkitektë të rëndësishëm përtej kufinjve të Shqipërisë. Qasja për mjedisin konsiston në ngritjen e një strukture agresive për pastrimin, nëpërmjet vendosjes së kamerave në Shëngjin, sistem oraresh, diferencim etj. Në bashkëpunim me GIZ-in dhe PNUD-in po planizohet një fushë e ndarjes në burim, diferencimi i mbetjeve ku

secila hidhet ne seksionin e vet si plastika vec, qelqi etj. Në lidhje me fushën e rinisë, bashkia ka fituar projektin për ngritjen e qendrës rinore , projekt i cili ka filluar zbatimin. Së fundmi është ngritur edhe Këshilli Vendor i Rinisë dhe jemi të hapur për propozime për projekte, ide nga të rinjtë për t'i financuar më pas ato.

Një qytetar ngriti si shqetësim levizjen e qenve të rrugëve, të cilët mund të jenë të rrezikshëm për kalimtarët. Në përgjigje të kësaj, u përmend projekti me veterinerët për vaksinimin, matrikullimin e kafshëve. Gjithashtu është edhe projekti për ngritjen e një qendre rehabilitimi për kafshët, jashtë zonës së qytetit, për të cilën vijon diskutimi me hipoteken për pronësinë.

Rruga që lidh Shëngjin me Hidrovorin u ngrit si problem nga një prej të pranishmëve, i cili evidentoi nevojën për investim në këtë aks rrugor por edhe nevojën për realizime të investimeve në bujqësi, duke marrë shkas nga tregu i cili ofron produkte me çmime shumë të larta.

Blloku i pallateve të tërmetit nga Pit Stop deri tek mobileria, zonë për të cilën ngelet problem parkingu u evidentua si shqetësim nga një prej qytetarëve. Ai ngriti si problem personal realizimin e një aplikimi në bazë të ligjit nr.20/2020 për disa dynymë tokë për të cilin akoma nuk ka marrë një përgjigje. Në lidhje me këtë shqetësim, kryetari evidentoi se tokat, ndarja e të cilave do të bëhet në bazë të ligjit 20/2020 janë të gjitha në proces sepse është një procedurë e ndërlikuar.

Z.Jak Gjini, ekspert i mjedisit vendosi theksin tek rreziqet klimatike, problemet e erazionit, shkarkimi i ujrave të zeza në lumin Drin. Gjithashtu duke theksuar rëndësinë që ka turizmi në Bashkinë Lezhë, evidentoi nevojën për investim në rrugën e Velës si një pikë e rëndësishme turistike e zonës. Kryetari deklaroi se për çështjen e erozionit duhet mbledhur një grup ekspertësh për të analizuar mirë situatën për të saktësuar çfarë projektesh duhen aplikuar, sepse fondet e bashkimit europian në këto fusha janë gati. Përsa i përket trashigimisë kulturore po zbatohet në kala projekti i Muzeut Arkeologjik i cili do ta konvertoje zonën në rrugë pelegrinazhi për të shkuar në kala.

Klodiana Kadeli, përfaqësuese e organizatës Power of Education evidentoi sipërmarrjen, aftësimin për hapjen e bizneseve, mentorimin, nevojën e granteve dhe zerimin e taksave si prioritete në fushën e rinisë dhe reflektimin e tyre në planet bashkisë. Në kushtet kur bashkia është përballur me problemin e borxhit, pandemisë, termetit, buxheti ka qenë i limituar në këtë drejtim por mbetemi të hapur për ide nga të rinjtë për të mundësuar edhe financimin e tyre.

Drejtori Ekzekutiv/INFOCIP, Gerti Shella evidentoi Bashkinë Lezhë si një ndër shtatë bashkitë e përzgjedhura nga 61 bashkitë e Shqipërisë me të mira të konsultimit publik.

Takimi u mbyll rreth orës 19.00 nga Kryetari i Bashkisë Lezhë.

**Drejtori i Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diaspores,
Komunikimit dhe Transparencës**

Elson Frroku



Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

Gjystina Nik-ulaj



